

Formulari Miratimi

(Shtesë e formularit të miratimit të informuar - për fëmijët 15-18 vjeç)

Titulli i Projektit: EARLY

Kërkuesi: Universiteti Mjekësor i Tiranës

Jemi duke zhvilluar një studim rreth shëndetit mendor tek të rinjtë. Një studim është një mënyrë shkencore për të mësuar më shumë rreth njerëzve. Në këtë studim do të mbledhim të dhëna në një pyetësor mbi shëndetin mendor dhe mbi faktorët që mund të kontribuojnë në shëndetin mendor. Nuk ka rreziqe nëse merrni pjesë në studim, por mund të ndjeni shqetësim. *Në rast të ndonjë shqetësimi, mund të ndaloni menjëherë plotësimin e pyetësorit.*

Kushdo që merr pjesë në këtë studim NUK do të ketë një përfitim të drejtpërdrejtë. Një përfitim do të thotë që diçka e mirë ju ndodh. Përfitimet e mundshme nga ky studim mund të jenë që publiku të ketë më shumë njohuri rreth shëndetit mendor të të rinjve dhe faktorëve që kontribuojnë në përmirësimin e shëndetit mendor të të tyre. Kur të kemi mbaruar me këtë studim, do të shkruajmë një raport rreth asaj që është mësuar. Ky raport nuk do të përfshijë emrin tuaj ose faktin që keni qenë në studim.

Mund të bëheni pjesë e këtij studimi nëse e dëshironi këtë. Mund ta ndërprisni pjesëmarrjen tuaj në çdo moment që dëshironi.

Prindërit tuaj janë informuar gjithashtu rreth studimit.

Nëse vendosni që dëshironi të merrni pjesë në këtë studim, ju lutemi pranoni duke klikuar kutinë.

Jam nën moshën 18 vjeç dhe njëri nga prindërit e mi dha miratimin për pjesëmarrjen time. E kam lexuar dhe kuptuar formularin e miratimit dhe jap pëlqimin tim për të marrë pjesë në studimin EARLY.